

VENDIM
Nr. 756, datë 5.9.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“NDËRTIM K/RRUGA NACIONALE LAÇ - PATOK (VAZHDIMI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtim K/rruga nacionale Laç - Patok (vazhdimi)”, të llojit arë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen arë prej 12 085 (dymbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e pesë) m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 3 359 630 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale në vlerën 265 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 3 359 630 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2013, zëri “Shpronësim”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar për këtë vit.
 6. Shpronësimi të fillojë nga data 15.9.2013.
 7. Pronarët e pasurive, të përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve në bazë të pikës 7 të këtij vendimi.
 9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin, të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
 SEKTORI I SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE
 SEGMENTI RRUGOR "Nderim K/Rruga Nacionale Laç-Patok"

Qarku:LEZHE
 Fshati: Fshati Laç

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	ARE			Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri			Sip. m2	Cmimi m2	Vlera ne leke	
1	Pren	Mark	Syziu	2365	3/9	1689	278	469542	Konfirmuar nga ZRPP
2	Pren	Mark	Syziu	2365	3/9	904	278	251312	Konfirmuar nga ZRPP
3	Gjon	Zef	Luka	2365	3/8	4256	278	1183168	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bardhok	Zef	Prenga	2365	3/13	157	278	43646	Konfirmuar nga ZRPP
5	Dile		Syziu + BP	2365	4/3	3818	278	1061404	Konfirmuar nga ZRPP
6	Dile		Syziu + BP	2365	4/4	1261	278	350558	Konfirmuar nga ZRPP
			TOTALI			12085		3359630	